

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË “PRIBUS” SHPK

NENI 1

Në Tiranë, sot më datën 07.03.2018, me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe legjislacionin shqiptar në përgjithësi, unë ortaku i vetëm, vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “PRIBUS” SHPK

NENI 2

Shoqëria “PRIBUS” SHPK, krijohet nga ortaku i vetëm:

Z. Teodor OSOJA, i biri i Dhimitrit dhe Lilianës, i datëlindjes 19.09.1965, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, lindur dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. Himë Kolli, Nd.32, H.3, Nr.11, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 025576418 dhe me Nr. Personal: G50919115K.

NENI 3

Shoqëria emërtohet “PRIBUS” SHPK

NENI 4

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Njësia 11, Rr. Hali Xhuzi, 1039, Tiranë.

NENI 5

Shoqëria “PRIBUS” SHPK ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë shtetit, në çdo kohë që do të shihet e arsyeshme prej saj me miratim të organeve kompetente.

NENI 6


Shoqëria “PRIBUS” SHPK gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi në Republikës e Shqipërisë. Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij Akti Themelimi i cili është pjesë përbërëse e tij.

NENI 7

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e kërkesës për regjistrim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe do të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar, sipas përcaktimeve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Shoqëria e mbyll aktivitetin e saj në çdo kohë me:

1. Me vendim të Ortakut të vetëm themelues;
2. Me vendim të gjykatës kompetente;
3. Me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore për falimentimin.
4. Me vendim të Ortakut të vetëm themelues, vendim i cili vendos shndërrimin e shoqërisë nga SHPK në një lloj tjetër shoqërie.
5. Në rastet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi të RSH.



Neni 8

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “PRIBUS” SHPK do të jetë:

“Të gjitha veprimtaritë dhe shërbimet që ligji u lejon shoqërive tregtare. Import dhe eksport, shitje me shumicë e pakicë, mallrash dhe prodhimesh të ndryshme. Import dhe eksport, shitje me shumicë e pakicë, e mjeteve dhe automjeteve të ndryshme me dhe pa motor të të gjitha llojeve e kategorive, për transport udhëtarësh, mallrash, e mjeteve lundruese të motorizuara apo jo, e mjeteve fluturuese, etj., si e mjeteve të tjera të veçanta, për qëllime dhe funksione të caktuara. Kryerja e shërbimeve dhe riparimeve të përgjithshme apo të specializuara për të gjitha llojet e mjeteve dhe automjeteve. Import dhe eksport, shitje me shumicë e pakicë, veglash, pjesësh këmbimi, nyjesh, agregatesh të mjeteve motorike dhe jo motorike të të gjitha llojeve dhe markave, vajrash lubrifikante, gomash dhe karburantesh. Modifikime teknike dhe ndryshime konstruktive të pajisjeve, mjeteve dhe automjeteve të të gjitha llojeve, që mund të ndryshojnë ose jo kategorizimin e automjetit, modifikime të shasisë dhe karrocërisë, të sistemit të djegies dhe injeksionit, të sistemit të drejtimit, të transmisionit, të tërheqjes apo shtytjes, të sistemit të frenimit, të sistemit të amortizimit, të sistemit elektrik e të motorit, modifikime dhe shndërrime të automjeteve me djegie të brendshme dhe mjeteve të tjera në automjete hibride apo plotësisht elektrike, etj. modifikime dhe vendosje impiantesh shtesë, si impiante gazi, elektrike, kondicionimi, ngrohje, etj. Prodhim pajisjesh, agregatesh, mjetesh dhe automjetesh me motor ose pa motor. Kontroll teknik dhe certifikim i të gjitha modifikimeve, ndryshimeve konstruktive, apo shndërrimeve të mundshme të mjeteve dhe automjeteve. Qiramarrje dhe qiradhënie afatshkurtër/afatgjatë apo financiare e veglave, pajisjeve, mjeteve dhe automjeteve, rrugore, lundruese apo fluturuese. Transport mallrash dhe udhëtarësh qytetës (urban), ndërqytetës (interurban), kombëtar dhe ndërkombëtar, me të gjitha kategoritë e mjeteve dhe automjeteve, rrugore, lundruese apo fluturuese, të të gjitha llojeve. Udhëtime turistike apo linje. Shërbim Taksi. Fluturime ajrore, kombëtare dhe ndërkombëtare, linje dhe jashtë linje (charter). Fluturime sportive, turistike, etj. Lundrim detar, kombëtar dhe ndërkombëtar. Fluturime ajrore dhe lundrim me hidroplanë. Biletari. Rezervime dhe prenotime të drejtpërdrejta, nëpërmjet të tretëve apo on-line, të të gjitha llojeve. Hoteleri. Organizim i të gjitha llojeve të eventeve me natyrë kulturore, shkencore, sportive, politike, festive, përkujtimore, familjare, etj., kombëtare dhe ndërkombëtare. Organizim udhëtimesh turistike të udhëhequra brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, detare, ajrore, malore apo fushore, sportive, si ture me ecje, ecje malore, ski, alpinizëm, sërif, vindsërif, rafting, zhytje nënujore, fluturime sportive, lundrim, gara të ndryshme, etj. Shitblerje, dhënie dhe marrje me qira, pronash dhe pasurish të tundshme dhe të patundshme. Agjent sigurimesh. Ndërtim.”

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe zotëruese e pasurive të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

Shoqëria mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta materiale, përfshirë të drejtën për të ofruar pasurinë e saj personave të tjerë dhe për të marrë kredi nga institucionet përkatëse financiare.

Neni 9


Administrator i shoqërisë “PRIBUS” SHPK do të jetë ortaku i vetëm themelues: z. Teodor Osoja i cili do ta ushtrojë këtë detyrë për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vjetësh.

Neni 10

Kapitali themeltar është 100 000 (njëqind mijë mijë) Lekë dhe i ndarë në 1 pjesë me vlerë nominale. Kapitali themeltar i shoqërisë është paguar e depozituar dhe është i gjithi kontribut i ortakut të vetëm themelues.

Neni 11

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie i takon ortakut të vetëm themelues.



Neni 12

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë, gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë nuk mban përgjegjësi për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tij që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Neni 13

Nuk mund të pranohet në këtë shoqëri, si ortak asnjë person tjetër pa miratimin e ortakut të vetëm themelues.

Pjesë të kapitalit të shoqërisë mund t'u shiten personave të tjerë që nuk bëjnë pjesë në këtë shoqëri, vetëm me vendim të Ortakut të vetëm themelues, gjithmonë me akt të shkruar dhe të vërtetuar nga organet përkatëse publike sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë.

Neni 14

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj do të rregullohen në bazë të kontratave të punës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 15


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë me persona të tjerë do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e tyre, do të jetë gjykata kompetente, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Ky Akt Themelimi, pasi u lexua dhe u gjet në përputhje me vullnetin tim e nënshkruaj atë rregullisht.

Tiranë, më 07.03.2018

ORTAKU I VETËM THEMELUES



Teodor OSOJA

